

RAPORTI PERMBLEDHES I PASQYRAVE FINANCIARE PER VITIN 2024

Shoqëria Lab Chem Distribution shpk është Regjistruar pranë QKB me datë 29/12/2021 me një kapital fillestar prej 10,000 Lekë dhe zotërohet nga këta ortakë:

1. Besar Hajdini me një kuotë prej 5,000 leke me 50% të pjesëmarrjes;
2. Lejdi Iljazi me një kuotë prej 5,000 leke me 50% të pjesëmarrjes.


dhe ushtron aktivitetin e saj me Adresë kryesore: Njësia administrative nr.12, rruga e Teleferikut, Zona Kadastrale Nr. 2460 , Numer pasurie 192/41-118, Linzë, Tiranë.
Dhe adresë dytësore:

Elbasan, Librazhd, Prrenjas, ap.nr.2/135+2-2, zona kadastrale 29/24, Prrenjas Librazhd.

Administrator i shoqërisë është Z.Lejdi Iljazi. Shoqëria

kishte të punësuar 3 (tre) punonjës në 31.12.2024

Objekti i veprimtarisë së saj është: Tregti me shumicë e pakicë pajisjesh laboratorike, kimikateve e reagentëve laboratorike, mjekësore e veterinarë, medikamenteve e lëndëve të para për prodhimin e tyre. b) Import-eksport i kiteve mjekësore, reagentëve mjekësor, i makinerive, pajisjeve industriale, lëndëve të para, artikujve të gatshëm dhe gjysëm të gatshëm industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, pijeve alkolike, konsulencë inxhinjerie dhe ekonomike në fushën e teknologjisë dhe ambientit, në menaxhimin e prodhimit dhe shërbimeve, ndërtime civile dhe industriale, prodhim materiale inerte, ndërtimi, aktivitet imobiliar, sipërmarrje dhe veprimtari komisionere, hapje laborator për analiza mjekësore, të industrisë ushqimore, të ambientit dhe të metrologjisë. c) Hapje laborator për analiza mjekësore të industrisë ushqimore të ambientit dhe të metrologjisë, tregëtim i mallrave me përdorim të dyfishtë. e) Dhënie me qera e 2 pajisjeve laboratorike. g) Tregëtim i artikujve të ndryshëm për zyra, për ambiente laboratorike, kancelari, mobilje laborator, pajisje kompjuterike, pajisje dhe materiale elektrike, hidraulike, elektromekanike, elektroshtëpiake, materiale ambalazhimi, pajisje motorike, pajisje rrjeti, pajisje industriale për prodhim të kimikateve, medikamenteve dhe industrinë ushqimore, pajisje didaktike dhe shkollore. h) Mirëmbajtje, servise, kalibrime të pajisjeve laboratorike, të pajisjeve matese të pajisjeve mjekësore, të pajisjeve monitoruese të ajrit dhe ujit dhe të pajisjeve të mbrojtjes në punë. i) Konsulencë për sistemet ISO. j) Konsulencë për prodhimin e materialeve të ndërrimit dhe bojërave të ndryshme. k) Inspektimit, testimit, certifikimit dhe të trajnimit të certifikuar, duke përfshirë ndër të tjera fusha të industrisë, energjisë, ndërtimit, transportit, punëve publike, në shërbim të Cilësisë dhe Sigurisë. l) Inspektimin dhe certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit, materialeve, produkteve, makinerive dhe pajisjeve , Ndërtimeve dhe Instalimeve Industriale, Mallrat dhe Ashensorëve dhe Pajisjeve Ngritëse. Për përmbushjen e objektit të saj Shoqëria: a) Mund të marrë pjesë dhe të jetë e interesuar në shoqëri dhe sipërmarrje, shqiptare apo të huaja, që kryejnë aktivitete të njëjta, të



ngjashme apo të lidhura me aktivitetin e saj ose të subjekteve pjesëmarrëse; b) Mund të lidhë kontrata shitblerje, përdorimi, shkëmbimi, sipërmarrje apo marrëveshje të tjera me investitorë, bashkë investitorë, pronarë trualli apo objektsh; c) Mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme ose të dobishme ose që kanë të bëjnë, përfshirë por pa u kufizuar në: ofrimin e garancive reale

dhe/ose personale për detyrimet e veta dhe së të tretëve, veprime me pasuri të luajtshme, të paluajtshme, tregtare dhe çdo veprim tjetër që ka të bëjë me objektin e saj ose që mundëson një përdorim më të mirë të strukturave dhe/ose burimeve ndëpërmjet shoqërive ose sipërmarrjeve në të cilat, direkt apo indirekt, Shoqëria ka pjesëmarrje apo kontrollin e tyre. Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushë ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj. Në hartimin e bilancit janë respektuar parimet e kontabilitetit si dhe standartet perkatese.

Pasqyrat paraqesin me vertetesi e besueshmeri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen financiare si dhe rrjedhen e parase. Ato ruajnë parimin e krahasueshmerise ku paraqitja e secilit element është në koherencë nga njëri ushtrim në tjetrin, ruajnë parimin e vleresimit ku çdo element është futur në llogari dhe është përfshirë në pasqyrat financiare si dhe keto pasqyra janë përgatitur dhe paraqiten në gjuhën shqipe dhe në njësine monetare kombetare pra në ALL.

Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.

Në bazë të ligjit 10091 të datës 05.03.2009 për auditimin ligjor të pasqyrave financiare sipas nenit 41 pika c shoqëria nuk i plotëson tre kushtet për të pasur një auditues.

1. POLITIKAT E KONTABILITETIT.

1.1 Bilanci së bashku me elementët e tij është përgatitur sipas kontabilitetit bazuar në S.K.K 2, sipas së cilës kontabiliteti siguron një zhvillim normal, pa konflikte duke shmangur një zhvillim kaotik të rregullave të tij. Performanca e shoqërisë paraqitet nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, ndërsa ndryshimi i gjendjes financiare të shoqërisë jepet nga pasqyrat e kapitalit dhe të fluksit të parave.

Hedhja e llogarive në periudhat raportuese dhe paraardhëse në bilancin për periudhën Janar-Dhjetor 2024 është bërë në përshtatje dhe sipas dhe sipas rregullave që kërkon S.K.K 2.

Bilanci kontabël është i përbërë nga aktivet, pasivet dhe kapitali i pronarit. Pasqyrimi i tyre në nëngrupet përkatëse është hartuar duke u bazuar në parimin e materialitetit duke dhënë një pamje të vërtetë e të sinqertë të situatës financiare.


Pasqyrat e bilancit janë ndërtuar mbi bazën e kontabilitetit rritës sipas së cilës veprimet dhe ngjarjet njihen kur ato kanë ndodhur. Sipas kuadrit konceptual shoqëria jonë me pasqyrat financiare të hartuara është një shoqëri e re me vijimësi dhe që do të vazhdojë operacionet e saj dhe në të ardhmen.

Në bazë të ligjit nr.9228 dt.29.04.2004 për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, sipas nenit 4 të këtij ligji ndërtimi i Pasqyrave Financiare është bërë sipas S.K.K 2.

Po ashtu, dhe lista e llogarive të përdorura për vitin 2024 për kontabilizimin është e njëjtë duke përdorur listën e re të llogarive.

Në ndërtimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2024 formularët e bilancit kontabël janë sipas kërkesave të S.K.K 2, kjo duke bërë klasifikimin përkatës të zërave të bilancit.

Bilanci kontabël është ndërtuar sipas S.K.K 2 duke ju përmbajtur parimit të moskompensimit sipas së cilës elementet e bilancit paraqiten në shumat e tyre bruto pa u kompensuar. Aktivet monetare, arka dhe banka janë



pasqyruar në bilanc me vlerën e tyre neto duke i zbritur amortizimin e akumuluar.

III-Paraqitja e Pasqyrave Financiare S.K.K 2

3.1.Bilanci paraqet informacion mbi pozicionin financiar të shoqërisë raportuese në fund të periudhës kontabël i cili ka tre përbërës kryesor (aktivet, pasivet dhe kapitalin). Sipas këtij standarti zërat e bilancit japin një përshkrim të përgjithshëm të politikave të ndryshme kontabël, në referencë të S.K.K ku përsëritësit kryesor të bilancit paraqiten sipas kriterit të likuiditetit. (pasqyra 1).

3.2.Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve paraqet performancën e shoqërisë në fund të periudhës kontabël. Kjo pasqyrë është ndërtuar në atë mënyrë që të japë një informacion mbi përbërësit e ndryshëm të rezultatit neto. Në këtë pasqyrë të ardhurat dhe shpenzimet klasifikohen në bazë të natyrës (shpenzime, lëndë e parë, personel, amortizim, etj.)

3.3.Pasqyra e fluksit të parash tregon hyrjen dhe daljen e parash në fund të periudhës kontabël të cilat raportohen të klasifikuara sipas qëllimit, të ndara në flukse parash nga veprimtaria e shfrytëzimit , investimit dhe financiare. (Pasqyra 3.)

3.4.Pasqyra e ndryshimit të kapitalit pasqyron gjithë ndryshimet e kapitalit që kanë ndodhur gjatë një periudhe kontable. (Pasqyra 4.)

Më poshtë po paraqesim klasifikimin e mëtejshëm të zërave të bilancit mbi instrumentat financiar.

S.K.K 3 A(1) Aktive financiare Afatshkurtra.

A(1).Mjete monetare rezultojnë në shumën 9,103,532 (Nentemilionenjëqindetremijëepeseqindetridhjetëedy) lek dhe rakordojnë me Pasqyrën financiare nr.1. Gjendja e llogarive monetare në bankë dhe arkë rakordojnë me konfermat e datës 31.12.2024.

Nr.	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2024	Janar-Dhjetor 2023	Ndryshimi
1.	Banka OTP ALL	7,907,586.97	650,861	7,256,725.97
2.	Banka BKT	721 065.5	0	721,065.5
2.	Arka	474,880	25,750	455,956

Më poshtë gjenden detajimet e llogarive që janë përdorur në hartimin e pasqyrave financiare të të ardhurave e shpenzimeve:

A.(1.3) Kërkesat për tu arkëtuar rakordojnë me llogaritë sintetike pasqyruar në Pasqyrën 1.

Nr.	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2023	Ndryshimi
1.	Klientë për mallra	5,201,989.6	497,040	4,704,949.6



2.	Instrumenta të tjera borxhi	0	0	0
3	Tatim mbi fitimin	0	252,064	-252,064
4.	TVSH	0	644,809	-644,809
5.	Detyrime ndaj ortakëve	0	0	0

S.K.K (3) B(1,2) Detyrimet Afatshkurtër për tu paguar.

Nr.	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2024	Janar-Dhjetor 2023	Ndryshimi
1.	Të pagueshme furnitorëve	10,197,433	1,834,533	8,362,900
2.	Të pagueshme personelit	0	0	0
3	Të pagueshme sig.shoq.	56,513	23,340	33,173
4.	Detyrime tatimore për TVSH	984,599	0	984,599
5.	Detyrime tatimore për tatim në burim	5,550	3,465	2,085
6.	Detyrime ndaj ortakëve	0	1,354,424	-1,354,424
7.	Hua të tjera			

Diferencat në sigurimet shoqërore dhe në tatimin në burim janë shlyer në muajin Janar 2023.

S.K.K (3) (1) Kapitallet e veta.

Është një kontratë që evidenton një interes të mbetur në aktivin neto të njësisë ekonomike.

Nr.	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2024	Janar-Dhjetor 2023	Ndryshimi
1.	Kapitali aksioner	10,000	10,000	0
2.	Rezerva Ligjore	0	0	0
3.	Rezerva të tjera	0	0	0
4.	Fitim i pashpërndarë	0	0	0
5.	Fitim (humbja) e periudhës	276,812	600,477	-323,665
6.	Lehtësitë tatimorë	0	0	0
	Totali	286,812	610,477	-323,665

A.II Aktivet Afatgjata (S.K.K 5)

Ky standart ka si objekt të përshkruaj një trajtim kontabël, paraqitjen në Pasqyrat Financiare të Aktiveve Afatgjata materiale.

Një AAM njihet në bilanc kur aktivi kontrollohet nga njësia ekonomike dhe është e mundur që nga përdorimi i këtij aktivi të ketë përfitime në të ardhmen dhe kosto e arkëtimit mund të matet me besueshmëri. Njohja fillestare e aktivit në bilanc vlerësohet me koston e blerjes përfshirë taksën e importit, taksa të tjera të parimbursueshme dhe kosto të tjera të drejtëpërdrejta që lidhen me sjelljen e aktivit në vendndodhje. Në datën e mbylljes së bilancit për vlerësimin e AAM zgjedhim modelin e koston që pasqyron koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e amortizueshme dhe amortizimi njihen në PASH si shpenzim në mënyrë sistematike përgjatë jetës së dobishme. Normat e amortizimit janë të ndryshme për çdo element të AAM.

Më poshtë po japim një klasifikim të zërave të bilancit të AAM.



AII.1 AAGJ materiale (me vlerën fillestare)

Nr.	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2024	Janar-Dhjetor 2023	Ndryshimi
1.	Toka	0	0	0
2.	Ndërtesa	0	0	0
3.	Makineri dhe Pajisje	817,352	1,021,691	-204,339
4.	Pajisje zyre	127,247	160,561	-33,314
5.	Mjete transporti	0	0	0
	Totali	944,599	1,182,252	-237,653

AII.2 Pasqyra e shtesave dhe pakësimeve të AAM (Me vlerë fillestare)

Nr.	Emërtimi	Çelje	Shtesa 2024	Pakesim 2024	Gjendja 31.12.2024
1.	Toka	0	0	0	0
2.	Ndërtesa	0	0	0	0
3.	Makineri dhe Pajisje	1,277,113	0	0	1,277,113
4.	Pajisje zyre	204,788	0	0	204,788
5.	Mjete transporti	0	0	0	0
	Totali	1,481,901	0	0	1,481,901

AII.3 Pasqyra e amortizimit të AAM.

Baza e llogaritjes së amortizimit është mbi vlerën neto për të gjithë grupet e AAM përveç ndërtesave që llogariten mbi vlerën fillestare. Për vitin 2023 ka amortizim të llogaritur.

Nr.	Emërtimi	Çelje	Amortizimi akumuluar	Vlera neto	Nr. %	Amortiz. Vjetor	Totali/Amort
1.	Toka	0	0	0	0	0	0
2.	Ndërtesa	0	0	0	0.5	0	0
3.	Makineri dhe Pajisje	1,021,691	812,355	817,352	0.20	204,338	204,338
4.	Pajisje zyre	160,562	58,852	127,247	0.25	33,315	33,315
5.	Mjete transporti	0	0	0	0		
	Totali	1,182,253	871,207	944,599		237,653	237,653

III. Pasqyra Fianciare (Të Ardhurave dhe Shpenzimeve) Nr.2.

Në përgjithësi të ardhurat dhe shpenzimet rregjistrohen të ndara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve pa i kompensuar me njëra-tjetrën , vetëm të Ardhurat dhe Shpenzimet që lidhen me veprimtarinë dytësore.

TË ARDHURAT S.K.K (8)

Ky standart ka si qëllim të përshkruaj trajtimin kontabël të të ardhurave, paraqitjen ne Pasqyrat Financiare të



tyre. Të ardhurat kontabilizohen kur është e mundshme që njësia të ketë përfitime dhe këto përfitime të maten me besueshmëri. Ato përfaqësojnë flukset kryesore gjatë periudhës kontabël që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësim të pasiveve si dhe rritjen e kapitaleve të njësisë.

Gjatë periudhës së vitit 2023 të ardhurat e shoqërisë kanë ardhur si rezultat i shitjes së mallrave dhe të furnizuara gjatë periudhës dhe ofrimit të shërbimeve.

Ato janë vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar.

Më poshtë po paraqesim një klasifikim të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Shitjet rakordojnë me shitjet e pasqyruara dhe të deklaruara në FDP e TVSH.

A.Të Ardhura

Nr.	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2024	Janar-Dhjetor 2023	Ndryshimi
1.	Shitje shërbimesh	2,109,400	1,424,101	685,299
2.	Shitje mallrash	37,606,287	10,506,307	27,099,980
3.	Të tjera	0	0	0
	Totali	39,715,687	11,930,408	27,785,279

B.Shpenzime

Nr.	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2024	Janar-Dhjetor 2023	Ndryshimi
1.	Materiale	149,920	256,420	-106,500
2.	Mallra	25,039,121	7,104,413	17,934,708
3.	Të tjera	0	0	0
	Totali	25,189,041	7,360,833	17,828,208

Shpenzime operative

Nr.	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2024		Janar-Dhjetor 2023	
604	Blerje, energji, avull, uje	LEK	43,668	42,465	
613	Qira	LEK	264,000	264,000	
618	Të tjera	LEK	1,419,619	176,362	
625	Transferime, udhëtime, dieta, pritje, percjellje	LEK	2,895,850	1,094,000	
626	Shpenzime postare dhe telekomunikimi	LEK	0	38,283	
628	Shpenzime për shërbimet bankare	LEK	16,277	37,650	
634	Taksa dhe tarifa vendore	LEK	22,800	22,800	
641	Pagat dhe shpërblimet e personelit	LEK	1,559,012	1,320,000	
644	Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	LEK	243,189	298,698	
657	Gjoha dhe dëmshpërblime	LEK	0	10,000	
658	Shpenzime të tjera korente	LEK	0	66,600	
681	Amortizimet e aktiveve afatgjatë	LEK	244,479	299,649	
769	Të ardhura nga këmbimet valutore	LEK	1,665		435
	Totali:		6,710,559 0	3,670,507	435



C.Rezultati kontabël.

Fitimi bruto, i cili llogaritet midis të ardhurave dhe shpenzimeve


Nr.	Emërtimi	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2023	Ndryshimi
1.	Të Ardhura	39,715,687	11,930,408	27,785,279
2.	Shpenzime	32,254,240	11,030,905	21,223,335
3.	Fitimi/humbje	7,461,447	899,503	6,561,944

A.III Pasqyra Financiare e fluksit të parasë .

Objekti i pasqyrës është të përshkruaj paranë e gjeneruar të përdorur nga njësia ekonomike raportuese, burimet e financimit dhe ndryshimet në pozicionin e parave si dhe ekuivalente të saj. Shoqëria përdor metodën direkte duke i pasqyruar të gjitha klasat kryesore të arkëtimeve të parasë dhe pagesave të paraqitura si shuma bruto.

A.IV Pasqyra financiare e ndryshimit të kapitalit Nr.4

Gjatë vitit ushtrimor shoqëria nuk ka bërë ndryshime në kapitalin e nënshkruar i cili është në masën 10,000 (dhjetëmijë) lekë. Ky kapital është ligjor dhe përputhet me ekstraktin e Qendrës Kombëtare të Biznesit.



SHENIMET SHPJEGUESE

Sqarim:

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2.
Plotesimi i te dhenave të kësaj pjese duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të percaktuara në SKK 2 dhe konkretisht paragrafeve 49-55. Rradha e dhenies së shpjegimeve duhet të jete :

- a) Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël
- b) Shënime që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare
- c) Shënime të tjera shpjeguese

Tiranë
Mars 2025

LAB CHEM DISTRIBUTION

(Për drejtimin e njësisë ekonomike)

Financiere

ELISA HAJDINI



Administrator

LEJDI ILJAZI

